



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I. Numër: 463/01-98159, dt. 30 Dhjetor 2024.

Në bazë të nenit 11, nenit 12 par.2 pika d, nenit 14 par.1 të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 të nenëve 5,6,8 dhe 14 të Ligjit nr. 06/L-092 mbi dhënen në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunës, nenit 4, nenit 5 paragrafi 1.3, nenit 6, nenit 13 dhe 14 të rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431.dt.30. shtator 2020, pasi shqyrtoj propozimin e Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak për dhënen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale – *Zyret në katin e III-të të Poliklinika Stomatologjike*, me rekomandim të Komitetit për Politik dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me date: dt. 30 Dhjetor 2024, merr këtë:

**VENDIM
Nr. 77/2024**

**Mbi miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale -
Zyret në katin e III-të të Poliklinika Stomatologjike**

I. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës miratimin paraprak për dhënen në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale - *Zyret në katin e III-të të Poliklinika Stomatologjike*, në afat prej tridhjetë e pesë (35) viteve sipas Vendimit Nr. 71-2023 mbi miratimin e listës së veçantë të pronave Komunale të Komunës së Pejës që do të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2024, me nr. Prot. 463-01/117215. dt. 28 Dhjetor 2023.

Nr.	PRONARI Poseguesi	Nr. i Ngastres	Emri i rrugës (lokacioni)	Sipërfaqja	Zona Kadastrale	Destinimi	Përiudha
1.	Komuna Pejë	1757-0	Rr. Nëna Terezë		ZK Pejë	Sherbime Gastronomike	35 vite

II. Pas plotësimit të kushteve ligjore komisioni për komunal për vlersimin e ofertave do të inicioj procedurën e tenderimit – ankandit publik, për zgjedhjen e ofertes më të favorshme për dhënen në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale - *Zyret në katin e III-të të Poliklinika Stomatologjike*, në afat prej tridhjetë e pesë (35)viteve.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi dhe dispozitave të ligjit për dhënen në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, obligohet që të kujdeset Komisioni Vlersuesë, Drejtoria për Çështje Pronëso-ro-Juridike.

IV.Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 (shtatë) pas publikimit në web faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:
MAPL-së,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ,
Arkiv.

